

VILMA PROKO-JAZEXHIU

**PROBLEME TË DEPËRTIMIT DHE TË NGULITJES SË  
ANGLICIZMAVE NË NIVELE TË NDRYSHME TË LIGJËRIMIT**

1. Zhvillimi dhe kultivimi i shqipes së sotme në këto 20 vjetët e fundit edhe në fushën e terminologjisë është shoqëruar me përballjen me gjuhët e kulturat e fuqishme të vendeve të mëdha, çka përbën një sfidë të madhe për të, e, në rend të parë, për leksikun.

Në mënyrë të veçantë, termat, si njësi emërtuese që bëjnë pjesë në leksikun e specializuar të gjuhës standarde, përbëjnë atë pjesë të leksikut, i cili ndikohet më shumë e më drejtpërdrejt nga gjuhët e huaja, sidomos nga ato gjuhë që janë në kontakt me të. Zhvillimi në gjerësi e në thellësi i shkencave dhe i teknologjisë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar ka shtuar, por edhe ka diferencuar kaq shumë fushat e dijës, sa që këto ndryshime të mëdha janë ndier në shtimin sasior të termave të huaj, sidomos të anglicizmave, të cilët kanë vërshuar në masë të madhe, sidomos në tekstet mësimore të shkollave të larta, në veprat dhe dokumentet shkencore e teknike, në doracakët e të gjitha llojeve e deri në thjeshtligjërime. Ndonëse para viteve '90, siç është theksuar me të drejtë, depërtimi i tyre ka çuar në krijimin e një shtrese leksiku të kufizuar, sidomos në pak fusha të shkencës e të teknikës, ku vend kryesor kanë zënë anglicizmat terma<sup>1</sup>, pas viteve '90, që përkon me fillimin e periudhës së hapjes së vendit tonë me botën, ata kanë depërtuar dhe janë ngulitur në terminologjitë e fushave të ndryshme të dijës, ku si veçori themelore e funksionimit të tyre në gjuhë është se ata takohen jo vetëm në pjesët e leksikut me përdorim të specializuar, por edhe kanë hyrë më thellë në gjuhë, sidomos disa prej tyre, ndonëse më të pakta, përdoren deri në thjeshtligjërime. Në këtë të fundit takohen anglicizma që funksionojnë si terma në fushat e reja të dijës, si informatika, telemetria, me përmbajtjet konceptore si të tilla, por me kuptime të thjeshtësuara, siç dëgjohen në të folurit e përdoruesve të zakonshëm të internetit, deri tek nxënësit, fëmijët: *klikoj, maus, monitor, printer, format, display* etj. Krahas anglicizmave terma njëfjalësh përdoren dhe njësi emërtuese më të zgjeruara, anglicizma terma togefjalësh, si: *kompjuter personal (personal computer), fajl hierarkik (hierarchical file)*<sup>2</sup>, *kompakt disk (compact*

---

<sup>1</sup> A. Duro & F. Vrapit, *Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe*, Konferenca shkencore "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe - probleme e detyra", Tiranë, 2009, f. 197-211.

<sup>2</sup> *Fjalor i Informatikës (anglisht-shqip, shqip-anglisht)* (N. Caka, A. Dika, S. Rodiqi), Prishtinë, 2005.

*disc*), *netuërk draiv* (*network drive*)<sup>3</sup> etj. Krahas tyre, janë kristalizuar e janë mëvetësuar edhe dy nënshtresa të tjera, të identifikuara në bazë të funksionit që kryejnë: anglicizmat që funksionojnë si fjalë të zakonshme si të vetme ose që krijojnë me fjalët shqipe sinonime, si: *shopping* dhe *pazar* (*psonisje*), *pab* dhe *lokal*, *parti* dhe *mbrëmje* (vallëzimi), si edhe anglicizma si fjalë librore (jotërma), që përdoren në masmedia, në publicistikë, në botën e spektaklit me diferencime kuptimore ose, sipas rastit, të njëjta me fjalë shqipe, si: *shou* dhe *spektakël*, *performancë* dhe *shfaqje*, *rezort* dhe *vend pushimi*. Me studimin e anglicizmave janë marrë kryesisht filologë që kanë studiuar anglistikë<sup>4</sup> etj., por edhe filologë me njohuri të nevojshme për gjuhët romane, me të cilat shqipja ka pasur marrëdhënie më të hershme, si E. Lafe, me synimin që çdo fjalë e brumit roman që përdoret në anglishte me po atë semantikë si në gjuhët romane të mos merret gabimisht si anglicizëm p.sh.: *absenteizëm*, *bizarr*, *debat*, *honorar*, *imperializëm*, *ingranazh*, *koalicion*, *permanent*, *pica*, *verdikt* etj. (Një fjalës më të zgjeruar e gjeni te artikulli *Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme*<sup>5</sup> dhe Xh. Lloshi, sipas të cilit, huazime të anglishtes në gjuhën shqipe janë ato që rrjedhin nga dukuria e gjuhëve në kontakt, të shqipes me anglishten dhe tashmë jemi përballë ndërhyrjes së huazimeve angleze në gjuhën shqipe<sup>6</sup>.

<sup>3</sup> N. Caka, *Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe dhe standardizimi i saj në fjalorë*, në “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë”, Tiranë, 2005.

<sup>4</sup> Çështje të marrëdhënieve të shqipes me anglishten kanë trajtuar Xhevat Lloshi, Hajri Shehu, Kristina Jorgaqi, Shykrane Gërmizaj, Shpresa Hoxha, Vesel Nuhiu, Irena Pata etj.

<sup>5</sup> E. Lafe, *Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme*, “Gjuha shqipe”, Prishtinë, 2011/1, f. 55-72; “Albanologji”, Vëllimi II. *Punimet nga aktiviteti shkencor “Java e Albanologjisë”* i mbajtur më 25-29 tetor. Instituti Albanologjik. Prishtinë, 2011, f. 291-307. (E. Lafe ka hartuar një listë prej mbi 600 anglicizma, që janë të njohur në një masë pak a shumë të gjerë njerëzish në Shqipëri dhe në Kosovë. Një pjesë e tyre, - pohon ai, - dikur emërtime të vetme për sendet ose nocionet përkatëse, sot kanë kaluar në leksikon pasiv, duke u zëvendësuar me fjalë shqipe të përshtatshme; për një pjesë tjetër është në zhvillim gara me një fjalë shqipe; ndërsa pjesa më e madhe janë shtruar këmbëkryq në leksikon e shqipes).

<sup>6</sup> Xh. Lloshi, *Raste ndërhyrjesh të huazimeve nga anglishtja*, “Studime filologjike”, 2011/1-2, f. 63-86. (Autori ndër të tjera shprehet: Nuk janë anglicizma fjalët e ardhura në shqipen nëpërmjet gjuhëve të tjera, kryesisht neolatine (Në këtë vështrim nuk pranohen si anglicizma të shqipes një varg fjalësh, që i ka trajtuar si të tilla H. Shehu); 2. Nuk mund të quhet huazim i shqipes çdo fjalë e huaj që ndeshet në kushtet e dygjuhësisë si në Ballkan, ashtu edhe jashtë trevës së shqiptarëve në Ballkan; 3. Nuk përfshihen te anglicizmat në gjuhën shqipe mjetet e anglishtes të përdorura brenda një teksti shqip për arsye të

Siç dihet, shenjë e ngulitjes së termave është përfaqësimi i tyre në fjalorë. E me këtë rast citojmë fjalët e Isak Azimovit nga libri *Fjalë të shkencës*: “Fjalori shkencor, nënvizon ai, ka mbetur ndërkombëtar, në një pjesë të madhe të tij. Shumica e termave shkencorë tingëllojnë, p.sh., rusisht, ashtu si edhe anglisht. Dhe kjo ka shumë rëndësi – pengesat artificiale ndërmjet shkencëtarëve të vendeve të ndryshme patjetër që do ta ngadalësonin zhvillimin e shkencës dhe, në qoftë se shkencëtarët e secilit vend do të kishin një fjalor shkencor të vetin, atëherë hendeku gjuhësor do të thellohej edhe më”.<sup>7</sup>

2. Pavarësisht nga sa më sipër, vlerë të veçantë përbëjnë anglicizmat pas viteve '90. Vështrimi i kësaj shtrese të sotme do të ishte me interes, nëse do të krahasohej me shtresën e anglicizmave terma para kësaj periudhe.

Qysh në v. 1982 prof. A. Kostallari vërente se “*Gjuha shqipe është gjuha ku kanë depërtuar më pak anglicizma se në çdo gjuhë tjetër të Europës*”<sup>8</sup>. Nga ana tjetër, një pjesë e tyre, ndonëse si terma, janë zëvendësuar me barasvlerës shqip, por jo gjithnjë me një fjalë të vetme, sidomos në fushën e sportit: *trajnoj-stërvit, penalti-njëmbëdhjetëmetërsh, hence-goditje dënimi, korner-goditje nga këndi, aut-pozicion jashtë loje, kros-vrapim në natyrë*. Me studimin e anglicizmave të leksikut terminologjik special si dhe vëzhgimet mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze është marrë H. Shehu<sup>9</sup>, të cilat i ka studiuar, nisur nga vendi që zinte një fjalë angleze ose me temë të prejardhur nga anglishtja në gjuhën shqipe. Duke u mbështetur edhe në konceptimin e tij ne mund të bënim paraqitjen e tyre të mëposhtme:

a) anglicizma që bënin pjesë në shtresat aktive, pak aktive apo pasive të leksikut ose të terminologjisë. Mund të vërehet se ato kanë depërtuar si terma të veçuar në pak fusha të veprimtarisë shoqërore, si: **ekonomi e tregti e jashtme**: *trust, licencë, eksport, import, klering, dollar, sterlinë* etj. (11 terma); në fushën politiko-shoqërore: CIA, Pentagon, bos, lider, raund (bisedimesh) etj.; **sport**: *gol, golaverazh, faull, aut, korner, start, trajner, kros, pas, set, dribloj, tenis* etj. (28 terma); **etnografizma** e, rrallë edhe si **ekzotizma**: *puritan, puritanizëm, tradunion, linçoj, bitëll, lord, tuist, kauboj* etj.; **detari**: *doker*; **shkencë e teknikë**: *xhaul, vat, kilovat, lazer, koks,*

---

ndryshme stilistike; 4. Nuk duhen marrë për shqyrtim si anglicizma në gjuhën shqipe rastet që vijnë nga padituria vetjake...)

<sup>7</sup> I., Azimov, *Fjalë të shkencës dhe historia pas tyre*. Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë. 1991, f. 9.

<sup>8</sup> A. Kostallari, Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, në “Studime filologjike”, 1982/2, f. 28-30.

<sup>9</sup> H. Shehu, *Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze*, “Gjuha jonë”, 1989/1, f. 42-48.

*logaritëm* etj.; **gjellëtari**: *buding, senduiç* etj.; **bimësi e bujqësi**: *greipfrut, kultivar, starking* etj.

b) Vihej re krijimi i vargjeve sinonimike me fjalë të tjera të gjuhës apo zgjerimi më tej i këtyre vargjeve, anglicizmat më pak përcaktuese e shprehëse (khs. **vrapin në natyrë**, *kros*) ose janë zhvendosur në shtresat pasive të leksikut (khs. **nisje** / *start*, **mbërritje** / *finish*, **goditje nga këndi/korne** etj.). Ato qenë kryesisht të njëkuptimshme, si: *bumerang, doping, koktej, rul* etj.

c) Për nga zhvillimi i fjalëformimit anglicizmat shërbejnë si temë për formim fjalësh të reja: në raste fare të rralla është formuar ndonjë gjysmëkalk (trokaqiell) ose kalk i drejtpërdrejtë (qiellgërvishtës). Për pasojë foljet *flirtoj, bojkotoj, skre moj, granuloj, linçoj, pasoj* janë të prejardhura nga njësitë angleze *flirt, boycott, cream, granulate, lynch, pass*, si formime brenda shqipes, që paraqiten si krijime hibride: kështu, peshën semantike e bart elementi anglez, si (*pass, flirt*), kurse elementi formësues është elementi formant shqip, si *pas-oj, flirt-oj*.

Për këtë periudhë përmbledhtazi, nxjerrim konkluzionin se anglicizmat kanë funksionuar pothuajse vetëm si terma në disa fusha të veçanta të dijes; si të tillë ata nuk kanë arritur të mëvetësohen plotësisht si shtresë me status të vetin në leksikun e shqipes. Në këtë këndvështrim kjo shtresë mund të krahasohet me rusizmat, italianizmat, francezizmat, gjermanizmat e ndonjë tjetër. Një ndër faktorët kryesorë ka qenë pikërisht mbyllja e vendit tonë me botën, çka pengonte edhe depërtimin e dukurisë së globalizmit në fushën e gjuhës e në mënyrë të veçantë te leksiku<sup>10</sup>. Megjithatë njësitë e saj mund t'i veçojmë në fusha speciale të veçanta të dijes, duke i renditur sipas shkallës së mbizotërimit sasior. Një pjesë prej tyre janë evidentuar në punime të veçanta të studiuesve: F. Leka<sup>11</sup>, H. Shehu,<sup>12</sup> V. Dervishi,<sup>13</sup> E. Dashi<sup>14</sup>, H. Pasho<sup>15</sup>, A. Duro<sup>16</sup> etj.

<sup>10</sup> Xh. Lloshi, *Facing the Globalization – the case of the Albanian Language*, “Studia Albanica”, 2005/2, f. 47-56.

<sup>11</sup> F. Leka, *Për njësimin, pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të terminologjisë tekniko-shkencore në gjuhën shqipe*, në përmbledhjen “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë, 1983, f. 121-127; *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1985, nr. 1, f. 53-62.

<sup>12</sup> H. Shehu, *Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe*, në përmbledhjen “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, 19, Prishtinë, 2001.

<sup>13</sup> V. Dervishi, *Formimi i terminologjisë së mekanikës në gjuhën shqipe*, Disertacion, Tiranë, 1990.

<sup>14</sup> E. Dashi, *Formimi i terminologjisë së zooteknisë në gjuhën shqipe*, “Studime filologjike”, Tiranë 1991, nr. 1.

3. Në kushtet e okonomisë së tregut, gjuhës shqipe iu desh të përballlej me anglishten, si gjuhë globaliste, e cila u bë masive në përdorim në mjedisin shqiptar. Gjuha shqipe u vu përballë anglishtes si mekanizëm i kufizuar gjuhësor për komunikim të natyrshëm me këtë kërkesë globale, çka bën që të përballojë me vështirësi trysninë leksikore të anglicizmave. Nga ana tjetër kjo vështirësi lidhet edhe me mungesën e teknologjisë së nevojshme gjuhësore për të përballur anglishten teknologjike. Fjalë të huaja që filluan të përdoren deri në ligjërimin e thjeshtë në zonat urbane fusha të ndryshme u vunë përballë përdorimit masiv të fjalëve shqipe në zonat rurale. Nevoja e urbanizimit masiv të mjaft dukurive që hynë në sistemin tonë ekonomik në zhvillim, bëri që të vërshojnë mjaft fjalë të huaja të pranishme. Kjo bën që ballafaqimi me to të marrë forma komplekse. Kështu, në botimet shkencore qysh në fillimet e kësaj periudhe u vu re një prirje e fortë, herë-herë mbizotëruese e trysnisë së globalizmit gjuhësor e përfaqësuar nga anglicizmat, ku vendin e parë e zë hyrja e tyre në terminologjitë e fushave të ndryshme të dijës. Jo vetëm në botime, por edhe në leksionet universitare, për shkak edhe të mungesës së teksteve mësimore shqipe në disa lëndë, çdo gjë që rekomandohet nga pedagogët për t'u lexuar nga studentët është kryesisht në gjuhën angleze. Edhe pse Fjalorët terminologjikë të botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë përfshijnë një numër të konsiderueshëm termash, nuk e përballojnë dot vërshimin e termave të rinj, veçanërisht për degë që kanë marrë zhvillim vitet e fundit në botë. Mjafton të ndjekësh ribotimet e disa librave referencë, nganjëherë edhe vetëm pas një viti, të cilat përmbajnë gjithmonë kapituj të rinj që lidhen me aspekte të reja dhe të tjera të trajtimit të problemeve të ndryshme, me teknologji të reja etj. Këto kërkojnë studime të mëtejshme, të kujdesshme dhe përpjekje të organizuara për t'i bërë të njohura rezultatet e tyre edhe përmes literaturës në shqipe.

Aktualisht është rregull që çdo artikull shkencor në anglisht, do ta ketë një abstrakt në këtë gjuhë. Ca më tepër gjuha e informatikës, e elektronikës dhe e kompjuterit është tërësisht anglisht: *akses, bajt, draft, databazë, DVD, flash, facebook, gigabajt, insert, logo, monitoring, online, PIN, roming, sit, tabloid, tabulat, target, uebfaqe* etj., ndërsa një pjesë e nevojshme në përdorimin e përditshëm të folur ka marrë mbaresat përkatëse shqip: *klikoj, sejvoj, fajlet, kompaktdisqet (CD-të), hackersat shqiptarë, softet kompjuterike, zgjidhje harduerike dhe softuerike* etj.

<sup>15</sup> H. Pasho, *Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe nga Rilindja deri në v. '80 të shek. XX*, Tiranë, 2005, 198 f.

<sup>16</sup> A. Duro, *Studime gjuhësore (terminologji, gjuhësi kompjuterike, kritikë-bibliografë)*, QSA, IGJL, Tiranë, 2012, f. 156-171.

Meqë futja e anglicizmave si shfaqje më e spikatur e globalizmit, është e përqendruar kryesisht në fushën e informatikës<sup>17</sup>, në vijim do të trajtoj disa probleme që hasen gjatë depërtimit dhe ngulitjes së anglicizmave terma, duke i konkretizuar me shembuj të vjelë nga “Fjalor i termave të informatikës” (2010)<sup>18</sup> me rreth 3000 terma dhe duke i klasifikuar si vijon:

- Anglizma që kanë hyrë në shqipe bashkë me konceptin, një pjesë e të cilëve përshtaten me strukturën fonetike të shqipes: me formë të njëjtë si në anglishte: *font, internet, monitor, printer, virus, kompjuter, rezolucion, skaner, faks* etj.

Një pjesë prej tyre kanë shërbyer si tema prodhuese, duke i futur ato në sistemin e fjalëve të shqipes: *skaner – skanoj – skanim - i skanuar; kompjuter – kompjuterizoj – kompjuterizim - i kompjuterizuar; printer – printoj – printim - i printuar* etj.

- Fjalë angleze që janë zëvendësuar nga fjalë shqipe, kryesisht ekzistuese si barasvlerëse të fjalëve angleze, një pjesë e të cilave përdoren krahas atyre shqipe, si:

*sejvoj (ruaj), navigoj (lundroj)* etj.

- Anglizma që vijnë si emërtime programesh ose produktesh tregtare, që nuk përkthehen në asnjë gjuhë dhe merren përmes transkriptimit, ose lihet në formën e vet origjinale.

*Internet Explorer, Microsoft, Outlook, Office, Power Point, Windows Media Player, WordArt* etj.

- Terma të rinj edhe për anglishten që nuk gjenden në fjalorët e gjuhës angleze ose gjenden me kuptime të tjera, ndër të cilët hasen terma të krijuar nga bashkime fjalësh, si: *modem (modulator + demodulator), blog (ueb + log), emoticon (emotion + icon)* etj.

- Anglizma në trajtë shkurtesash të ndryshme që janë standardizuar e që mbeten të tilla për çdo gjuhë, përfshirë shqipen

*CPU (Njësia qendrore e përpunimit) - CPU (Central Processing Unit)*

*LAN (rrjeti i zonës lokale) - LAN (Local Area Network)*

*WWW (Rrjeti mbarëbotëror) - WWW (World Wide Web)* etj.

<sup>17</sup> Shih 4. (Lafe i ka klasifikuar anglicizmat sipas fushave tematike, ku p.sh. në fushën leksiore: kompjuter, informatikë, internet ka gjetur 77 syresh). Shih edhe “Fjalor i Informatikës” (anglisht-shqip, shqip-anglisht) (N. Caka, A. Dika, S. Rodiqi), Prishtinë, 2005.

<sup>18</sup> L. Shishani, A. Çerpja, A. Çepani “Fjalor i termave të informatikës” (anglisht-shqip-anglisht), Prishtinë, 2010. (Problemet që hasen gjatë depërtimit të termave anglezë në gjuhën shqipe janë trajtuar edhe në *Shqipja dhe terminologjia kompjuterike*, Seminari Ndërkombëtar i Prishtinës, 29/1, f. 275-282 dhe *Probleme të lokalizimit të termave të teknologjisë informative në shqip*, Seminari I Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë – Ohër, shtator 2007, f. 192-203).

Me sa duket, është e logjikshme që këta terma të anglishtes të mbeten siç janë, për arsye të formës së tyre origjinale, pasi bëhen më të kuptueshëm dhe orientues për specialistin e fushës. Për t'i mëshuar fort çka më sipër, sjellim në vëmendje Janet Byron. "Emërtesat teknike janë ndoshta format më prestigjioze në botën moderne (khs. Del Rosario, kreu II), përderisa ato simbolizojnë përparimin shkencor, ekonomik dhe teknik"<sup>19</sup>.

Lind pyetja. Mos vallë duhet të ndryshojë diçka në konceptin themelor të fjalorëve terminologjikë, që mendoj se ka të bëjë a) me ruajtjen e disa termave themelorë në format e tyre origjinale (anglisht), duke kryer transkriptimet e përshtatshme, por pa mëtuar të japim terma shqip, të cilët ose janë po aq të panjohura për specialistët dhe në disa raste të pasuksesshëm, edhe për shkak të mbartjes së disa kuptimeve, përveç atij terminologjik<sup>20</sup>; b) me propozimin e saktë për terma sidomos togefjalësh; c) me hartimin e fjalorëve shpjegues, më shumë sesa të fjalorëve shumëgjuhësh pa shpjegime etj.

Grupi hartues i Fjalorit të termave të informatikës (Tiranë, 2010) pohon në Parathënien e këtij fjalori se "janë pasur parasysh dhe zgjidhje që ofrohen nga fjalorë të mëhershëm, qofshin ato të përgjithshëm apo specialë, për të futur edhe terma shqip si shpërhapje (për *difuzion*); tejçim (për *transmetim*); shpeshësi (për *frequencë*); tregues (për *indeks*), selection (*përzgjedhje*) etj. Por këta terma janë po aq të nevojshëm edhe për fusha të tjera të shkencës, si fizika, matematika etj. Këtu bëhet fjalë për terma si ata të përmendur më lart, për fusha të tilla si f.v., gjenetika, e cila është tashmë një hop në zhvillimin e saj. Rastin kur vetëm termi me zanafillë nga anglishtja është i përshtatshëm; rastin kur shfaqen të dy termat, termi shqip i ndjekur nga termi i huaj në kllapa, dhe më në fund rastin kur edhe vetëm termi shqip mund të jetë i mundshëm dhe i përshtatshëm.

Nisur nga më sipër anglicizmat terma do t'i klasifikonim në dy grupe sipas numrit të fjalëve që përmban një term: Anglicizmat njëfjalësh dhe anglicizmat togefjalësh, ku të parat zënë vend qendror në terminologjinë kompjuterike, sepse përdoren më vete dhe si pjesë përbërëse e termave togefjalësh. Ato mund të jenë fjalë të thjeshta, të prejardhura dhe kompozita.

- *Anglicizmat njëfjalëshe me fjalë të thjeshta* ku çdo termi njëfjalësh në anglisht i përgjigjet një term njëfjalësh në shqip, si: *rezervoj-allocate*, *kufizues-border*, *stacionoj-dock* etj. Ka dhe raste kur kuptimi i termit njëfjalësh në anglisht i përgjigjet termi disafjalësh në shqipe: *njësi e diskut-drive*, *shënim me penë-ink*, *shënoj me flamur-flag*, *ngre një nivel-promote*,

<sup>19</sup> J. Byron, *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës. Rasti i shqipes dhe shkrime të tjera*, Dituria, 2012, f. 155.

<sup>20</sup> P.sh., çfarë mund të thuhet për termin shqip të cilit i korrespondon *Home Page*? Propozoj që termi të mbetet ky.

*transmetim i vazhdueshëm–stream, lëviz ngadalë–nudge* etj. Por hasen edhe ndërtime parafoljore të tipit: *në dispozicion–available, pa zë–mute* etj.

-*Anglicizmat njëfjalëshe me fjalë të prejardhura.* Siç dihet termat e krijuar me ndajshesim zënë një vend të rëndësishëm në si në gjuhën burimore, ashtu edhe në gjuhën shqipe. Në përgjithësi, çdo termi të prejardhur të anglishtes i përgjigjet një term gjithashtu i prejardhur në shqipe, por me raste edhe ndonjë kompozitë: *përshtatës–adapter, shfletues–browser, aftësoj–enable, largoj–remove* etj.

-*Anglicizmat njëfjalëshe me kompozita.* Në terminologjinë tekniko-shkencore është e njohur prirja për përdorimin e termave kompozita, pasi koncepti paraqitet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes dy temave motivuese me ngarkesë të madhe semantike. Kjo kategori termash zë një vend zë një vend relativisht të vogël në raport me ato njëfjalësh, madje dhe gjegjëset e një numri të vogël prej tyre në shqipe janë kompozita: *gateway – portëkalim, spreadsheet – fletëllogaritëse, strikethrough – i mesvijëzuar* etj. Ndërkaq, një pjesë e këtyre termave kompozita të anglishtes i kanë gjegjëset e tyre në shqipe terma togfjalësh, si: *autoshapen – forma të gatshme, clipboard – kujtesa e fragmenteve, toolbar – shiriti i veglave* etj. Ka edhe kompozita kur termi shqip është i prejardhur apo i thjeshtë, si: *download – shkarkoj, overview – shqyrtim, playback – rilexim, nickname – nofkë* etj.

Duket krejt qartë që gjuha angleze ka marrë stafetën në të gjithë literaturën dhe kërkimin shkencor. Termi anglez, sikurse dhe çdo term tjetër i huaj, është e nevojshme të vështrohet i ballafaquar me termin shqip në kuadrin e kërkesave që ai duhet të kënaqë, për t’u përfshirë si njësi e përshtatshme në një sistem terminologjik të një fushe të caktuar të dijes në gjuhën shqipe, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që japin mjetet termformuese në terminologji, për të rritur anën cilësore të saj dhe për ta bërë të aftë të transmetojë një nivel të lartë kulture, të mishëruar në rezultatet e shkencës dhe të teknologjisë. Për ta rrokur çështjen në tërësinë e saj, po rimarr prof. Lafen “që është e nevojshme të inventarizohen anglicizmat e shqipes (në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni), të ndiqet ecuria e përdorimit dhe e përshtatjes së tyre, ose me një term të informatikës, të krijohet baza e të dhënave për anglicizmat<sup>21</sup>, mbi të cilën mund të ndërmerren studime të ndryshme.

<sup>21</sup> E. Lafe, po aty.